



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.995/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komuna e Parteshit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Tatimi në Pronë, kundër debitorit “Albi-Oil” SH.P.K., me seli në fshatin Budrigë e Poshtme-Partesh, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.H. dhe D.H., të dy avokat nga Gjilani, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.264/23 të datës 05.06.2023, të Përmbaruesit Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 21.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Albi-Oil” SH.P.K., dhe ANULOHET Urdhri përmbarimor P.nr.264/23 i datës 05.06.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Parteshit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa-Tatimi në Pronë, ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.264/23 të datës 05.06.2023, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.3354393508 të datës 23.01.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, në emër të borxhit për tatimin në pronë, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,380.74 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe shpenzimet e tjera të krijuara në pajtim me UA-MD.Nr.01/2022, në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e shumës përkatëse te përmbaruesi privat, regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi, me shënimin e përmbarimit në librat publik të paluajtshmërive dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit të cilat ndodhen në posedim dhe pronësi të tij deri në vlerën e borxhit dhe shpenzimeve përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se kërkesa është e parashkruar në kuptim të nenit 354 të LMD-së. Ka shtuar se duke e marrë parasysh faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa periodike atëherë në kuptim të par. 2 të nenit 354 të LMD-së, kreditori ka humbur të drejtën jo vetëm që të kërkoj prestime të ardhshme periodike, por edhe prestimet të cilat kanë arritur për pagesë para këtij parashkrimi. Më tutje ka theksuar se nuk mund të konstatohet se për cilën kohë kërkohet përmbushja e detyrimit monetar, përkatësisht propozimit për përmbarim nuk i janë bashkangjitur transaksionet e periudhave kohore nga të cilat është kërkuar përmbushja e detyrimit tatimor dhe se kreditori propozimit për përmbarim ia ka bashkangjitur faturën ku totali i vlerësimit të tatimit të vlerësuar për vitin 2023 është 92.70 euro, edhe pse deri në përfundim të vitit kalendarik kanë mbetur më tepër se 6 muaj dhe sipas kësaj fature nuk mund të obligohet debitori të paguaj tatim në pronë për periudhën për të cilën ende ka afat për ta paguar. Ka shtuar se debitori vlerëson se gjykata duhet të caktoj një seancë dëgjimore në mënyrë që të saktësohet nga kreditori se shuma e kërkuar sipas urdhrit a është borxh real. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri Përmbarimor P.nr.264/23 i datës 05.06.2023.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka theksuar se procedura përmbarimore është iniciuar në bazë të faturave të cilat i plotësojnë kushtet ligjore sipas LPP-së, sepse janë origjinale, të nënshkruara dhe përmbajnë të gjitha elementet sipas nenit 29 par 1.3 i LPP-së, dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje nga debitorit. Më tutje ka shtuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara dhe se qëllimi i tij është prolongimi i procedurës, ngase propozimi për përmbarim është i iniciuar në bazë të faturave periodike nga tatimi në pronë që arrijnë shumën prej 2,380.74 €, ku nga kartela e klientit shihet obligimi i debitorit i arritur në periudha të ndryshme. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin debitorit, dhe urdhri për lejin e përmbarimit P.nr. 264/23 i datës 05.06.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 22, par.1, nën-par 1.9 përcaktohet se: *“dokumente përmbaruese janë: dokument tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues”*.

Në rastin konkret, meqenëse kreditori ka iniciuar procedurën përmbarimore mbi bazën e faturës së tatimit në pronën e paluajtshme, Gjykata, iu referua Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 27 të saj i cili përcakton se *“Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”*, ndërsa me nenin 30, par.1 të këtij ligji përcaktohet se *“Nëse pas njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve kalendarike nga dita e fundit për pagesë, në përputhje me paragrafin 1. të nenit 27 të këtij Ligji, pagesa ende nuk është bërë, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e treqind (300) Eurove”*.

Ndërsa, neni 30, par.7 i këtij ligji parasheh se: *“Brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së marrjes së vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara, autoriteti që ka marrë vendimin kërkon autoritetit kompetent përmbarues përmbarimin e vendimit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën përmbarimore. Një kopje e propozimit për përmbarim së bashku me dokumentet e bashkëlidhura i dërgohen menjëherë debitorit”*.

Nga dispozitat e lartcekura, Gjykata gjen se përmbarimi i borxheve të tatimit mbi pronën e paluajtshme i nënshtrohet formës së veçantë, ashtu që komuna si kreditor mund t'i arkëtoj borxhet e tatimit në pronë vetëm mbi bazën e një vendimi mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore, i cili vendim duhet nxjerrë pas kalimit të afatit prej 180 ditëve nga dita e dorëzimit të njoftimit për pagesën e detyrimeve tatimore tek debitori.

Nga rastin konkret, Gjykata gjen se kreditori propozimit për përmbarim i ka bashkëngjitur faturën e tatimit në pronë nr.3354393508 të datës 23.01.2023, por që në shkresat

e lëndës mungon vendimi mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore, të cilit dokument me ligj të veçantë i është njohur cilësia e dokumentit përmbarues për arkëtimin e detyrimeve tatimore, kjo në përputhje me nenin 22, par.1, nën-par. 1.9 të LPP-së i cili parasheh mundësinë që si dokument përmbarues të shërbej edhe dokumenti të cilit me ligj të veçantë i është njohur atributi i tillë.

Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se fatura e tatimit në pronë nr.3354393508 e datës 23.01.2023, nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarimit të detyrimeve tatimore në mungesë të vendimit mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore siç përcaktohet me nenin 30, par.7 të Ligjit për tatimin mbi pronën e paluajtshme, andaj prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, par.1.1 i cili përcakton se *“Prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”* dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Andaj, në mbështetje të nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.995/23 datë 21.09.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.